



REPUBLIKA E SHQIPERISË



**UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS**  
**SENATI AKADEMIK**

Nr. 957/17 Prot.

Tiranë, më 18/04 /2023

**VENDIM**

**Nr. 12, datë 18.04.2023**

**PËR**

**MIRATIMIN E PROPOZIMIT PËR NDRYSHIME NË STRUKTURËN E FAKULTETIT TË INXHINIERISË SË NDËRTIMIT, NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK TË TIRANËS**

Mbështetur në Ligjin Nr. 80/2015, datë 22.7.2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 38, pika 1, germa ç, Statutin e UPT-së, neni 9, pika 3, germa c, në propozimin e njësisë kryesore, në Vendimin e Dekanatit të Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit Nr. 16, datë 08.03.2023, në relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Juridike Nr. 583/2 Prot., datë 18.04.2023 të Universitetit Politeknik të Tiranës, Senati Akademik në mbledhjen e datës 18.04.2023,

**VENDOSI:**

1. Të miratojë kalimin e një pozicioni personel akademik me kohë të plotë nga Departamenti i Konstruksioneve të Ndërtimit dhe Infrastrukturës së Transportit në një pozicion personel akademik me kohë të plotë në Departamentin e Gjeodezisë, në Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit, në Universitetin Politeknik të Tiranës.
2. Të miratojë kalimin e një pozicioni personel akademik me kohë të plotë nga Departamenti i Mekanikës së Strukturave në një pozicion personel akademik me kohë të plotë në Departamentin e Gjeodezisë, në Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit, në Universitetin Politeknik të Tiranës.
3. Të miratojë kalimin e një pozicioni personel akademik me kohë të plotë nga Departamenti i Hidraulikës dhe Hidroteknikës në një pozicion personel akademik me kohë të plotë në Departamentin e Gjeodezisë, në Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit, në Universitetin Politeknik të Tiranës.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

**Prof. Dr. Andrea Maliqari**